



DHOMA E AVOKATISË TIRANË
Av. Arbër HOXHA
Licence: 4252
NIPT L 01721002 R

Rr. Haxhi Hysen Dalliu, Pallati Nordin, Zyra Nr. 8, Tiranë Cel: +355694290448

Shkodër, më 06. ____ .2019

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Drejtuar: Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

Z. Gjyqtar Sokol SHEHU!

Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

I kerkuar per ekstradim: Ilir Rustemi (Bajri), i biri Januz dhe Zoje, dtl 12.10.1976, lindur dhe baues në Shkodër, Dobraq me masë sigurimi "Arrest në burg", IEVP Shën Koll, Lezhë, mbrojtur nga Av. Arbër Hoxha, Anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, me Liçencë me Nr.4252 dhe NIPT L01721002R dhe/ose nga Av. Sokol Tahiraj, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, me Nr. Licence 6920 dhe NIPT K 81521011 R, me adresë Rr. "Haxhi Hysen Dalliu" P. Nordin, Zyra, Nr. 8, Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 378, 488- 503 i Kodit të Procedurës Penale.

I nderuar Z. Kryetar i trupit gjykues!

Ne, Av. Arbër HOXHA dhe Av. Sokol Tahiraj, mbrojtës të posacëm të Ilir Rustemi (Bajri), i kerkuar per ekstradim, gjatë shqyrtimit gjyqësor arritëm të provojmë se Kërkesa për ekstradimin e shtetasit shqiptar Ilir Rustemi (Bajri) është në kundërshtim me ligjin dhe provat dhe si e tillë duhet rrëzuar, pasi :



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË SHKODËR

DISKUTIMI PERFUNDIMTAR

PËR MIRATIMIN E LEJIMIT TË EKSTRADIMIT TË SHTETASIT SHQIPTAR
ILIR RUSTEMI ALIAS BAJRI
NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË NË REPUBLIKËN E ITALISË

I nderuar z.Kryetar i Seances !

Ministria e Drejtësisë me shkresën Nr.88/6 Prot.,B.K., datë 04.03.2019, në vijim të komunikimeve mbi arrestimin për qellime ekstradimi nga Shqipëria në Itali shtetasit shqiptar Ilir Rustemi alias Bajri, i biri i Januz dhe i Zoje, lindur më 12.10.1976 në Dobraq, Njesia Administrative Rrethina, Bashkia Shkoder, banues po aty, ka përcjell kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Italisë me nr. Ref. MA - 1421 - 2018 - SN - GF, datë 20.02.2019, së bashku me dokumentacionin përkatës që i përket kërkesës së themelut të kërkesës për ekstradimin e këtij shtetasi.

Ky material është dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme Drejtorinë e Maredhenieve Juridiksionale me Jashtë Tirane, e cila e ka përcjell me shkresën Nr. 874/22 Prot., (J.B.), datë 05.03.2019 dhe ka marrë numer hyres 265/1 Prot, datë 05.03.2019 në Prokurorinë Prane Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane.

Prokuroria prane Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane, me shkresën nr. 265/6 Prot (A.H) datë 19.03.2019, ka dërguar në Prokurorinë Prane Gjykatës së Shkallës së Parë Shkoder fashikullin mbi të arrestuarin Ilir Rustemi alias Bajri me përmbajtjen si vijon:

Në kuadër të kërkesës për ekstradimin për jashtë të shtetasit shqiptar Ilir Rustemi alias Bajri, i biri i Jonuz dhe i Zoje, i dtl. 12.10.1976, lindur dhe banues Dobraq-Shkoder, nga Shqipëria në Itali, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane me vendimin e datës 18.03.2019 ka deklaruar moskompetencën tokësore për vazhdimin e gjyqimit të kësaj kërkesë dhe kalimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkoder si gjykatë kompetente.

Bashkelidhur kësaj shkrese janë dërgur aktet që i përkasin kërkesës për ekstradimin e shtetasit shqiptar Ilir Rustemi alias Bajri nga Shqipëria në Itali.

Nga përmbajtja e dokumentacionit, për ekstradimin e shtetasit shqiptar Ilir Rustemi alias Bajri, nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë, rezulton se:

I. Kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Italisë, me Nr Ref MA-1421-2018 SN-GF, e datës 20.02.2019, me objekt ekstrimin e shtetasit shqiptar Ilir Bajri, në dy faqet e saj në asnjë gërmë të saj nuk jep garanci (kushtin e shprehur) se i ekstraduari nuk do të ndiqet, nuk do të dënohet dhe as do t'i dorëzohet një shteti tjetër për një vepër penale që ka ndodhur para kërkesës për dorëzim dhe që është e ndryshme nga ajo për të cilën është dhënë ekstradimi.

Duke mbajtur parasysh edhe faktin, që shtetasi Ilir Rustemi është dënuar në mungesë edhe në shtetin Belg (ku Republika e Shqipërisë nuk ka marrëveshje ekstradimi), mungesa e këtij kushti të shprehur, sipas parashikimeve të Nenit 490 të K. Pr. Penale, i cili sanksionon se: "1. Ekstradimi lejohet me kusht të shprehur se i ekstraduari nuk do të ndiqet, nuk do të dënohet dhe as do t'i dorëzohet një shteti tjetër për një vepër penale që ka ndodhur para kërkesës për dorëzim dhe që është e ndryshme nga ajo për të cilën është dhënë ekstradimi.

2. Kushtet e treguara nga paragrafi 1 nuk merren parasysh:

a) kur pala dorëzuese jep pëlqim të shprehur që i ekstraduari të ndiqet edhe për një vepër penale tjetër dhe i ekstraduari nuk ka kundërshtim;

b) kur i ekstraduari, edhe pse ka patur mundësi, nuk ka lënë territorin e shtetit të cilit i është dorëzuar, pasi kanë kaluar dyzet e pesë ditë nga lirimi i tij ose pasi e ka lënë atë është kthyer vullnetarisht.

3. Ministria e Drejtësisë mund të vërë edhe kushte të tjera që i çmon të përshtatshme pa tejkaluar parashikimet e akteve ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe rezervat e deklaratimet ligjor" do të rrezikonte lirinë dhe të drejtat themelore të shtetasit Ilir Rustemi (Bajri) dhe ne nuk japim pëlqimin për këtë (sipas parashikimeve të Nenit 490/2/a të K. Pr. Penale.

II. Vendimi penal i formës së prerë, për të cilin kërkohet ekstradimi është i Gjykatës së Ravenës, (lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Bolonja), mban Nr. 532/07, datë 16.07.2008, për të kërkuarin Ilir Rustemi (Bajri) është dhënë në mungesë të tij, dhe me avokat të caktuar kryesisht (aavocato Giovanni Proni fq 15 e fashikullit

30.06.2019 si dhe për t'u hequr emri i subjektit PUK nga fletët e votimit për këshillat bashkiake në të gjitha njësit vendore ku kemi paraqitur listat për kandidatë në këto këshilla bashkiake të vendit.

Presidenti i Republikës brenda afatit të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë si dhe në Kodin Zgjedhor, në mbështetje të nenit 92, shkronja "gj", dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9, paragrafi 1, të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me Dekretin nr.10928, datës 05.11.2018 ka caktuar datën 30 qershor 2019, si ditë për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.

Partia e Unitetit Kombëtar, nëpërmjet nëpërmjet Kryetarit të saj, Av. Idajet Beqiri, ka paraqitur pranë KQZ kërkesën dhe gjithë dokumentacionin përkatës për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 30 qershor 2019. Ky dokumentacion është administruar prej KQZ me nr.380 prot., datë 20.02.2019.

Në vijim, brenda afatit të parashikuar nga Kodi Zgjedhor, Partia e Unitetit Kombëtar (PUK) është regjistruar si subjekt zgjedhor pranë KQZ me Vendimin nr.37, data 11.03.2019 të saj.

Po brenda afateve ligjore kemi paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm sipas kërkesave të Kodit Zgjedhor për të gjitha KZAZ-të e Republikës të listave për këshilltar bashkiak dhe filluam fushatën zgjedhore ditën që ajo u çel e në vazhdimësi, duke respektuar datën e zgjedhjeve të përcaktuara me dekretë nga ana e Presidentit të Republikës, atë të 30 qershorit 2019.

Në datë 10.06.2019, Presidenti i Republikës Zoti Ilir Meta, me Dekretin nr.11199, datë 10.06.2019 ka vendosur "Shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 5.11.2018 të Presidentit të Republikës "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", duke anuluar datën 30 qershor 2019, si ditë e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

Në mbledhjen e datës 10.06.2019 KQZ vlerësoi se Dekreti nr.11199, datë 10.06.2019 i Presidentit të Republikës është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, për rrjedhojë nuk sillte asnjë pasojë juridike dhe kështu vendosi të vijojë më tej me përgatitjet për zgjedhjet e datës 30.06.2019.

PUK, pasi u njoh me këtë dekret të Presidentit të Republikës, me anën e të cilit ç'dekretonte dekretin nr.10928, datës 05.11.2018, si dhe pasi e analizoi atë në tërësinë e tij, paraqiti kërkesën me objekt sa sipërcitohet.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve me Vendimin Nr._____ datë 13.06.2019 vendosi rëzimin e kërkesës së Partisë së Unitetit Kombëtar (PUK) për t'u çregjistruar nga zgjedhjet për pushtetin vendor të 30 qershorit 2019, si dhe për t'u hequr emri i subjektit PUK nga fletët e votimit për këshillat bashkiake në të gjitha njësit vendore ku kemi paraqitur listat për kandidatë në këto këshilla bashkiake të vendit.

të Prokurorisë), dhe gjithashtu Kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Italisë, me Nr Ref MA-1421-2018 SN-GF, e datës 20.02.2019, me objekt ekstrimin e shtetasit shqiptar Ilir Bajri, në dy faqet e saj në asnjë gërmë të saj shteti Italian nuk jep garanci për rishikimin e vendimit, duke ardhur kështu në kundërshtim flagrant me parashikimet e Nenit 491/f të K. Pr. Penale i cili sanksionon se: **"Mospranimi i kërkesës për ekstradim**

Nuk mund te jepet ekstradimi:

f) kur personi i kërkuar është dënuar në mungesë, me përjashtim të rastit kur shteti kërkuar jep garanci për rishikimin e vendimit.

III. CETERIS PARIBUS

Shtetasi i kërkuar për ekstradim Ilir Rustemi (Bajri) është në procedim penal në Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Procedimi Penal mban Nr. 60, të vitit 2018, dyshuar për veprat penale të "Shtërngim me anë të kanosjes për dhënie pasurie" kryer në kuadër të grupit të strukturuar criminal, parashikuar nga nenet 109/b-333-334 të Kodit Penal.

Pavarësisht dijenisë të Prokurorisë së Shkallës së Parë Tiranë që shtetasi Ili Rustemi (Bajri) po mbahej me masë sigurimi arrest në burg, për llogari të krimeve të rënda, dijeni që buronte nga shkresa Nr. 874/12 Prot, datë 11.01.2019 të Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë me Marrëdhëniet me Jashtë, i është drejtuar me shkresë (email) 20 Prokurorive të Rretheve Gjyqësore të gjithë territorit të Rep ë Shqipërisë dhe Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë nuk i është drejtuar, nëse ky shtetas kishte apo jo procedim penal.

Në këto kushte i jemi drejtuar, ne si mbrojtës me Shkresën Nr. 2269 Prot, datë 18.03.2019, dhe na është kthyer përgjigje nga Prokuroria e Shkallës së Parë për Krime të rënda Tirnaë me anë të shkresës Nr. 2269/1 Prot, datë 09.05.2019, ku citohet se: "Ilir Rustemi (Bajri) është në procedim penal në Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Procedimi Penal mban Nr. 60, të vitit 2018, dyshuar për veprat penale të "Shtërngim me anë të kanosjes për dhënie pasurie" kryer në kuadër të grupit të strukturuar

Meqënëse Partia e Unitetit Kombëtar ka marrë cilësinë e subjektit zgjedhor dhe mund ti drejtohet Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë në mbështetje të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, në të cilin parshikohet se, subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi, po ju drejtohem juve me anën e këtij ankimi kundër kësaj vendimarrje të gabuar të KQZ.

Jemi brenda afatit ligjor të parashikuar nga Kodi Zgjedhor për të paraqitur këtë kërkesë përpara Kolegjit Zgjedhor, pasi sipas nenit 152, pika 2, ky afat është 5 ditë nga shpallja e vendimit prej KQZ.

Theksojmë para Jush se Partia Unitetit Kombëtar është bërë pjesë e koalicionit "Për Shqipërinë europiane", regjistruar si i tillë me vendim nga ana e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

Ndodhur në këto kushte të reja ligjore dhe historike, të paprecedenta për subjektin tonë zgjedhor në historinë e shtetit shqiptar, Partia e Unitetit Kombëtar, e vetëdijshme për arsyet e vërteta që sollën këto rrethana të reja prej këtij çdekretimi të datës së zgjedhjes prej Presidentit të Republikës, mbloodhi organet e saj drejtuese për të diskutuar rreth kësaj situatë tepër problematike.

Në mënyrë unanime u vendos që Partia e Unitetit Kombëtar për shkak të nxjerrjes nga Presidenti i Republikës të Dekretit nr.11199 datë 10.06.2019, me anën e të cilit bënte "Shfuqizimin e Dekretit të tij nr.10928, datë 5.11.2018 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", autorizoi Kryetarin e Partisë për të kryer këto veprime:

1. Të bëjë kërkesë pranë KQZ-së për tu ç'regjistruar si subjekt për zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019 dhe të hiqet emri i subjektit PUK nga fleta e votimit.

2. Të ndiqen të gjithë hapat e nevojshëm ligjorë për realizimin e këtij qëllimi.

3. Të sensibilizohet e gjithë antarësia e Partisë dhe i gjithë opinioni publik për vendimet e mara.

Në datë 13.06.2019 Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi kërkesën tonë, pa respektuar të drejtën tonë materiale dhe procedurale për të marrë pjesë në zgjedhje dhe për të konkuruar konformë dispozitave ligjore, si dhe për t'u tërhequr prej tyre kur procesi deformohet prej Kryetarit të shtetit, në mënyrë arbitrare, me vendimin e datës 13.06.2019 vendosi:

"Rrëzimin e kërkesës për ç'regjistrim nga zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qeshor 2019 dhe heqjen e emrit nga fletët e votimit, të Partisë Uniteti Kombëtar."

Vendimi i KQZ-së në vlerësimin tonë është një akt i marë në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Shqipërisë dhe të Kodit Zgjedhor, pasi kushdo subjekt merr pjesë në zgjedhje, voton dhe garon lirisht, sikurse tërhiqet po lirisht prej tyre, posaçërisht në kushtet kur procesin zgjedhor e deformojnë dhe e cënojnë institucionet e rëndësishme të shtetit, sikurse është Presidenti i Republikës.

criminal, parashikuar nga nenet 109/b-333-334 të Kodit Penal.

Me datën 21.09.2018, nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë është caktuar masa e sigurisë arrest në burg, parashikuar nga Neni 238 i K. Pr. Penale.

Në këto kushte, duke qënë se shtetasi i kërkuar për ekstradim Ilir Rustemi (Bajri) është në procedim penal në Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Procedimi Penal mban Nr. 60, të vitit 2018, dyshuar për veprat penale të "Shtërngim me anë të kanosjes për dhënie pasurie" kryer në kuadër të grupit të strukturuar criminal, parashikuar nga nenet 109/b-333-334 të Kodit Penal, nuk mund të ekstradohet në Itali, kjo sipas parshikimeve të Nenit 491/c të K. Pr. Penale i cili sanksionon se: "Mospranimi i kërkesës për ekstradim

Nuk mund te jepet ekstradimi:

c) kur personi qe kerkohet ka kryer nje veper penale ne Shqiperi;

KËRKOJ :

Për sa më sipër, në bazë të nenit 490/1 dhe 491/c dhe 491/f të K. Pr. Penale kërkojmë rrëzimin e kërkesës për ekstradimin e shtetasit shqiptar Ilir Rustemi (Bajri), i biri Januz dhe Zoje, dtl 12.10.1976, lindur dhe baues në Shkodër, Dobraq me masë sigurimi "Arrest në burg", IEVP Shën Koll, Lezhë për në Republikën e Italisë.

1. Për këtë arsye, në bazë të Nenit 356-378 të Kodit të Procedurës Penale provat ku mbështesim preteordin tonë janë këto:

1. Kthim përgjigje, Nr. 2269/1 Prot, datë 09.05.2019, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
2. Vendim Nr. 133, datë 21.09.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për caktimin e masës së sigurisë « arrest në burg », 238 të K. Pr. Penale, me shënimin lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me Vendimin Nr. 51, datë 06.12.2018.

Vendimmarrja e KQZ duket se detyron elektoratin dhe vetë subjektin zgjedhor kërkues, Partinë e Unitetit Kombëtar, që të marrë pjesë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 30 qershorit 2019, ndërkohë që gara për zgjedhjet e pushtetit vendor duhet të jetë e lirë dhe jo detyruese.

PER KETO ARSYE

Bazuar në nenet 64, 65,72, 73, 145, 152 e vijuesa të Ligjit Nr.10019, date 29.12.2008 "Per Kodin Zgjedhor te Republikes së Shqiperise", i ndryshuar,

KERKOJME

Prishjen e Vendimit Nr. _____ datë 13.06.2019 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve me anën e të cilit është vendosur rrezimi i kërkesës së Partisë së Unitetit Kombëtar (PUK) për t'u çrregjistruar nga zgjedhjet për pushtetin vendor të 30 qershorit 2019 dhe pranimin e kërkesës sipas objektit të saj.

**KRYETARI I PUK
AV. IDAJET BEQIRI**



3. Vendim Nr. 135, datë 24.09.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për marrjen në pyetje të të arrestuarëve, me shënimin lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me Vendimin Nr. 36, datë 12.10.2018.

Mbrojtësit
Av. Arbër HOXHA

Av. Sokol TAHIRAJ



-Shtetasi shqiptar Ilir Rustemi alias Bajri, i biri i Januz dhe i Zoje, lindur me 12.10.1976 ne Dobrac, Njesia Administrative Rrethina, Bashkia Shkoder, banues po aty, eshte shpallur ne kerkim nderkombetar per shkak se ne ngarkim te tij ka nje vendim penal denimi Nr.14087/2010 - REG.GEN.2041/2009 RGNR - 7518/2001, date 17.05.2011 te Gjykates se Apelit te Bolonjas Itali, me te cilin eshte denuar me 8 vjet e 6 muaj muaj burgim per kryerjen e veprave penale "Shfrytezim prostitucioni", "Emigracion klandestin" dhe "Falsifikim dokumentesh". Denimi i mbetur per te kryer rezulton te jete 5 (pese) vjet e 6 (gjhashte) muaj burgim.

-Veprat penale per te cilat shtetasi shqiptar Ilir Rustemi alias Bajri kerkohet nga autoritetet e drejtesise italiane gjenden te parashikuara edhe ne dispozitat e Kodit Penal te Republikes se Shqiperise ne nenet 114 "Shfrytezimi i prostitucionit"; 186 "Falsifikimi i dokumenteve"; 297 "Kalimi i paligjshem i kufirit shteteror".

Neni 489 i Kodit te Procedures Penale i Republikes se Shqiperise, parashikon se:

"Kerkesa per ekstradim

1. *Ekstradimi lejohet vetem mbi bazen e nje kerkese drejtuar Ministrise se Drejtesise.*
2. *Kerkeses per ekstradim i bashkengiiten:*
 - a) *kopja e vendimit te denimit me burgim ose e aktit te procedimit;*
 - b) *nje relacion mbi vepren penale qe i ngarkohet personit per te cilin kerkohet ekstradimi, duke treguar kohën dhe vendin e kryerjes se vepres dhe cilesimin ligjor te saj;*
 - c) *teksti i dispozitave ligjore qe do te zbatohen, duke treguar nese per vepren per te cilin kerkohet ekstradimi eshte parashikuar nga ligji i shtetit te huaj denimi me vdekje;*
 - ç) *te dhenat individuale dhe çdo informacion tjeter te mundshem qe sherben per te percaktuar identitetin dhe shtetesine e personit, per te cilin kerkohet ekstradimi.*
3. *Kur konkurojne disa kerkesa ekstradimi, Ministria e Drejtesise cakton radhen e shqyrtimit. Per kete qellim ajo mban parasysh te gjitha rrethanat e çeshtjes dhe veçanerisht datën e marrjes se kerkeses, rendesine dhe vendin e kryerjes se vepres penale ose shtetesine dhe vendbanimin e personit te kerkuar, si dhe mundesine e nje riekstradimi nga shteti kerkuar.*
4. *Ne qofte se per nje shkelje te vetme ekstradimi kerkohet ne te njejten kohe nga shume shtete, ai i jepet shtetit ndaj te cilit eshte drejtuar vepra penale ose atij shteti mbi territorin e te cilit eshte kryer vepra."*

Bashkelidhur kerkeses eshte edhe teksti i dispozitave ligjore perkatese.

Procedurat per ekstradimin e ketij shtetasi jane duke u ndjekur me mase sigurimi "arrest ne burg".

Po ashtu, nga verifikimet e kryera ne rruge elektronike, rezulton qe ne ngarkim te ketij shtetasi ka te rregjistruar procedim penal ne Prokurorine Prane Gjykates se Shkalles se Pare te Krimeve te Renda Tirane.

Rezulton se kjo kerkesa permban te gjithë elementet e parashikuar nga neni 489 i Kodit te Procedures Penale.

Perfundimisht, bazuar ne gjithe dokumentacionin mbi ekstradimin e shtetasit shqiptar Ilir Rustemi alias Bajri nga Republika e Shqiperise ne Republiken e Italise, mbeshtetur ne Mareveshjen ndermjet Republikes se Shqiperise dhe Republikes se Italise, si edhe te shteses se Konventes Europiane per Ekstradimin te 13 Dhjetorit 1957 dhe te Konventes per Ndhime te Ndersjellte Juridike ne Fushen Penale, ratifikuar me ligjin Nr. 9871 date 11.02.2008 (i cili ka hyre ne fuqi me date 01.08.2011) si edhe te neneve 488 e vijues dhe nenit 378 te Kodit te Procedures Penale te Republikes se Shqiperise, Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare Shkoder;

KERKON:

1.Miratimin e kerkeses.


2.Lejimin e ekstradimit te shtetasit Ilir Rustemi alias Bajri, i biri i Januz dhe i Zoje, lindur me 12.10.1976 ne Dobraq, Njesia Administrative Rrethina, Bashkia Shkoder, banues po aty, (ndjekur me mase sigurimi "Arrest ne bug" te dhene me vendimin nr.69 date 21.01.2019 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane), nga Republika e Shqiperise ne Republiken e Italise, sipas kerkeses se autoriteteve te drejtesise italiane.

3.Ekzekutimi i ekstradimit te pezullohet, sepse Gjykata e Apelit Shkoder me vendimin nr.215 date 24.09.2018 ka caktuar ndaj shtetasi shqiptar Ilir Rustemi alias Bajri masen e sigurimit "Arrest ne burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

-Ekzekutimi i ekstradimit te pezullohet edhe sepse Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krimet e Renda Tirane ka regjistruar ndaj shtetasit shtetasit Ilir Rustemi alias Bajri procedimin penal Nr.60/2018 per veprat penale te parashikuara nga nenet 333/a, 334 e 109/b, 283/a te K.Penal dhe procedimin penal Nr.228/2018 per veprat penale te parashikuara nga nenet 278, 279, 79/dh-25-22, 78-25, 79/e-25, 109-25, 152, 197, 333/a te K.Penal.

-Procedimi penal Nr.60 i vitit 2018 dhe procedimi penal Nr.228 i vitit 2018 jane ne fazen e hetimit.

PROKURORI
Federik Laloshi



REPUBLIKA E SHQIPERISË
PARTIA E UNITETIT KOMBETAR (PUK)
SELIA QENDRORE

Adresa: Kutia Postare 8288, Tiranë,
Tel. 068 20 02 951 & 069 27 50 898
E-mail ldajetbegiri@hotmail.com

Nr.13/06 Akti

Tiranë, më 14. 06. 2019

KËRKESË PADI

PADITES : **PARTIA E UNITETIT KOMBETAR (PUK)**, perfaqesuar prej kryetarit te saj Av. Idajet Beqiri.

I PADITUR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE TIRANE

OBJEKTI I PADISW: Kundvrshtimi i Vendimit Nr. _____ datë 13.06.2019 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve me anën e të cilit është vendosur rrëzimi i kërkesës së Partisë së Unitetit Kombëtar (PUK) për t'u çrregjistruar nga zgjedhjet për pushtetin vendor të 30 qershorit 2019.

BAZA LIGJORE: Nenet, 64, 65,72, 73, 145, 152 e vijuesa të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Per Kodin Zgjedhor te Republikes së Shqipërisë", i ndryshuar.

**KOLEGJIT ZGJEDHOR PRANË GJYKATËS SË APELIT
TIRANË**

Të nderuar Zonja dhe Zotrinjë të Kolegjit Zgjedhor,

Partia e Unitetit Kombëtar (PUK), pasi u njoh me Dekreti nr.11199, datë 10.06.2019 i Presidentit të Republikës, i botuar në Fletoren Zyrtare nr.84, me anën e të cilit bëri ç'dekretimin e dekretit nr.10928 "Për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në datë 30 qershor 2019, si dhe pasi e analizoi këtë akt të paprecedent në tërësinë e tij, ju drejtua me një kërkesë KQZ për t'u ç'rregjistruar nga procesi zgjedhor për zgjedhjet për pushtetin vendor të datës